



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.3198/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-048 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2021/01 për Komuna Nr.01/508 e datës 15.05.2020, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2020 merr:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2021-2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2021-2023 e cila përmban planifikimet buxhetore nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021 është në lartësi prej 2,590,312 €, ndërsa projeksionet për vitin 2022 janë në shumë prej 3,154,853 € dhe për vitin 2023 janë në shumë prej 3,255,290 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2021 sipas pikës 1 të këtij vendimi, mjetet nga financimi qeveritar (granti i përgjithshëm, granti i arsimit dhe i shëndetësisë) janë në shumë prej 2,272,447 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 87.73%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 317,865 € apo 12.27%.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2021 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe shtesa 1,540,658 €, Mallra dhe shërbime 329,258 €, Shpenzime Komunale 60,000 €, Subvencione dhe transfere 67,940 € dhe Shpenzime kapitale 592,456 €.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Ky vendim iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorëve të Drejtorive,
- Ministrisë së Financave dhe Transfereve – Departamentit të Buxhetit,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.06.2020

